



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2023:128189
Datë: 05.06.2024
Numri i dokumentit: 05782373

2023:128190

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Armend Ahmeti, në çështjen juridike të paditësit B.H. nga Shtimja, rr. ..., nr..., të cilin e përfaqëson i autorizuari av. Faton Fetahu nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna Shtime, të cilën e përfaqëson L.M., avokat komunal, për shkak të anulimit të vendimit, pas shqyrtimit paraprak të padisë dhe pas mbajtjes së seancës përgatitore të dt. 03.06.2024, me datën 05.06.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Gjykata Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, **shpallet INKOMPETENTE në pikëpamje lëndore**, për të vendosur në këtë çështje juridike.

II. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, **shkresat e kësaj lënde t'i dërgohen Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore në Prishtinë**, si gjykatë me kompetencë lëndore që është.

A r s y e t i m

Paditësi B.H. nga Shtimja, rr. ..., nr. ..., të cilin e përfaqëson i autorizuari av. Faton Fetahu nga Prishtina, më dt. 07.06.2023, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna Shtime, për shkak të anulimit të vendimit nr. 05-...1-9317/23 i nxjerrë nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave.

I autorizuari i paditësit av. Faton Fetahu nga Prishtina në seancën përgatitore të dt. 03.06.2024, ka deklaruar se mbesim në tërësi pranë kërkesepadise se parashtruar sepse konsiderojme se e njejta është rezultat i nje procedure te paligjshme te cilen e ka zhvilluar e paditura me rastin e rekrutimit te pozites se mesimdhenesit te lendeve zgjedhore- integrim

evropiane ne te cilen kishte aplikuar paditesi, ne rrethanat e ketij rasti shkeljet ligjore te nderlidhura me marredhenien e punes jane te karakterit edhe material dhe procedural, e para fakti se paditesi nuk eshte intervistuar nga komisioni i perzgjedhjes me perberjen e tij te plote duke bere qe e paditura permes ketij komisioni paditesit ose nuk e ka vleresuar fare ne pjesen e njerit anetar te komisionit i cili ka munguar ose vleresimin per te e kane bere anetaret e tjere te komisionit. Nje fakt i tille nuk eshte kontestuar as nga e paditura ne dhenien e pergjigjes ne ankesat fillestare, mirepo nje rrethane e tille eshte teresisht e vlefshme per ta kualifikuar proceduren e rekrutimit te kunderligjshme respektivisht ne kundersiztim me udhezimin ne fuqi per themelimin e marredhenies se punes (nr.072017) si dhe ne aspektin material ne kundersiztim me udhezimin administrativ ne fuqi per kuadrin profesional ne arsimin e pergjithshem mbi bazen e te cilit paditesi ishte me i thirrur per ta ushtruar poziten e shpallur ne konkurs, pervec tjerash edhe per faktin se i njejt per dallim nga kandidati fitues, ka pervoje pune si mesimdhenes. Ne keto rrethana paditesi ishte drejtuar me anekese te paditures perkatesisht komisionit per anekesa te te paditures, anekese e cila nuk e kishte trajtuar as edhe nje pretendim te vetem te tij. Paditesi ne baze te legjislacionit ne fuqi per kategorite e familjeve te martireve te luftes ka konsideruar se duhet te trajtohet ne menyre te barabarte dhe ne rastin qe i ka permbushur kriteret me mire se kandidati fitues i njejt te kualifikohej per kete pozite, prandaj permes kesaj padie kerkon qe te anulohet procedura e rekrutimit dhe e paditura ta kthej proceduren duke evituar te gjitha shkeljet perkatese.

Per sa i perket kompetences lendore te gjykates per shqyrtimin e kesaj padie konsiderojme se ne baze te aktit te kontestuar e njejta do te duhej te transferohej per shqyrtim dhe vendosje ne Departamentin per Ceshtje Administrative te Gjykates Themelore ne Prishtine.

I autorizuari i të paditurës L.M., avokat komunal, në seancën përgatitore të dt. 03.06.2024, ka deklaruar se mbetemi ne teresi prane pergjigjes ne padi, qe ne fillim po deklarohemi lidhur me kompetencen e Gjykates Themelore ne Ferizaj, ne si pale e paditur mendojme dhe konsiderojme se kompetente per te vendosur lidhur me kete lende eshte Gjykata Administrative ne Prishtine duke aluduar ne ate se punen e organeve administrative e kontrollon gjykata permes Gjykates Administrative. Sa i perket padise se paditesit te gjithen e kemi shtjelluar ne pergjigjen ne padi duke filluar ne ate se paditesi ka konkuruar ne vendin e punes si mesimdhenes i lendes integrimi evropiane prane Shkolles se Mesme te Ulet “ E.D.” ne Shtime. Pas perfundimit te te gjitha procedurave te konkursit, paditesi nuk eshte pranuar ne kete vend pune sipas komisionit te intervistimit paditesi ka gene i katerti ne liste dhe diferenca e pikeve ne

mes te kandidatit i cili ka fituar dhe paditesit ka qene 14.5 pike. Paditesi pastaj ka vazhduar me ankesen e tij prane komisionit te ankesave e cila i eshte refuzuar nga komisioni i ankesave pasi qe paditesi nuk ka ofruar asnje prove as fakt lidhur me te drejten qe ai e pretendon.

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, duke u bazuar në nenin 17 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), kjo gjykatë ka gjetur se në rastin konkret kemi të bëjmë me çështje administrative, përkatësisht me kërkesën për anulimin e vendimit nr. 05-...-9317/23, të datës 08.05.2023 të nxjerrë nga Komisioni për shqyrtimin e ankesave në sektorin e arsimit të Komunës së Shtimes, i cili vendim paraqet akt administrativ përfundimtar, i nxjerrë në procedurën administrative dhe i bazuar në Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Sipas nenit Neni 44 të Ligjit Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L -031, thuhet se: “Akti administrativ 1. Akti administrativ është çdo manifestim vullneti i një organi publik, që rregullon në mënyrë të njëanshme një marrëdhënie juridike konkrete të së drejtës administrative, me qëllim prodhimin e pasojave juridike, dhe: 1.1. u drejtohet një ose disa personave individualisht të përcaktuar (në vijim: “akti”). Ndërsa me nenin 2 të Ligjit nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative parashihet se: “Qëllimi Qëllimi i këtij ligji është sigurimi i mbrojtjes gjyqësore të të drejtave dhe interesave juridike të personave fizik, juridik dhe palëve të tjera, të cilat të drejta dhe interesa janë cenuar me vendime individuale ose me veprimet e organeve të administratës publike.” dhe neni 13 i po të njëjtit ligj ku thuhet se: “Konflikti administrativ 1. Konflikti administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë. 2. Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative ankimi nuk është i lejuar.” Me nenin 14 të Ligjit për Gjykatat nr.03/L-199, është përcaktuar në mënyrë të qartë se “Departamenti për Çështje Administrative i Gjykatës Themelore gjykon dhe vendos në konfliktet administrative sipas padive kundër akteve administrative përfundimtare dhe për çështjet e tjera të përcaktuara me ligj”. Duke qenë se bazuar në Ligjin mbi Gjykatat, për kontestet e kësaj natyre, Gjykata Themelore në Ferizaj, përkatësisht Departamenti i Përgjithshëm i saj, nuk ka kompetencë lëndore, kjo gjykatë gjeti se për çështjen në fjalë, e njëjta duhet të shpallet inkompetente në pikëpamje lëndore dhe se kjo lëndë duhet t’i dërgohet Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore në Prishtinë, si gjykatë me kompetencë lëndore që është. Meqenëse vendimi i Komisionit është akt administrativ dhe i njëjti është përfundimtar në procedurë administrative, ndaj tij lejohet të inicohet konflikti administrativ me padi.

Me nenin 1 të LPK-së parashihet që: “Me Ligjin për procedurën kontestimore caktohen rregullat procedurale në bazë të të cilave gjykata i shqyrton dhe i zgjidhë kontestet nga marrëdhëniet juridiko-civile të personave fizikë dhe juridikë, po që se me ligj të posaçëm nuk është përcaktuar ndryshe.” Duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore del përfundimi i drejtë dhe i ligjshëm se çështja 2023:128190 nuk përbën çështje civile, ku mbi bazën e kësaj do të mund të konstituohej kompetenca e Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamentit të Përgjithshëm, por çështja në fjalë përbën çështje administrative, e cila duhet të gjykohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, e në bazë të neneve 17 dhe 19 e lidhur me nenin 392, pika “b” të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm

2023:128190, datë 05.06.2024

Gjyqtari

Armend Ahmeti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditëve pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj gjykate.